



# NJË PROJEKT EVROPIAN PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËSIMIT NË SPORT PËRMES FORMAVE TË REJA

## ARSYETIMI DHE HISTORIKU

Me evoluimin e sportit evropian, nevoja për një forca pune të kualifikuar, të përfshirë dhe profesionale po rritet gjithnjë e më shumë. Megjithatë, rekrutimi dhe mbajtja e personelit me aftësi të nevojshme paraqet një sfidë të madhe. Mungesa e aftësive është e përhapur, veçanërisht pas COVID, dhe sporti ka një numër të lartë punëtorësh të punësuar me kohe te pjesshme dhe të vetëpunësuarish. Tendencat tregojnë që të rinjtë largohen nga sektori herët, dhe shumë vende kanë një fuqi të madhe punëtore të padeklaruar.

Faktorë si puna sezonale, kontratat e shkurtëra të ofruara nga punëdhënësit e ndryshëm, bashkë me oraret jo te pershtatshme, e vështirësojnë ndërtimin e karrierave të suksesshme të jetës në sport për njerëzit. Studimet tregojnë se praktikat tradicionale të punësimit, bazuar në marrëdhënien një për një midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, nuk ndihmojnë. Forma të reja dhe më fleksibël të punësimit, si ndarja e punonjësve, menaxhimi përkohshëm, puna në platforma dhe puna nga shtëpia/dixhitale, bazuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, mund të ofrojnë disa zgjidhje për këtë problem.

## QËLLIMI

Qëllimet e përgjithshme të kësaj nisme transnacionale janë:

- + **Përgatitja** e një raporti kërkimor evropian i cili shqyrton tërësisht sfidat e punësimit me të cilat përballet sporti, ndikimin e praktikave tradicionale të punësimit në rekrutimin dhe mbajtjen dhe potencialin e formave të reja të punësimit për të adresuar këto çështje.
- + **Formulimi**, konsultimi dhe shpërndarja e rekomandimeve dhe politikave për vendimmarrësit në nivelet evropiane, kombëtare, rajonale dhe vendore mbi format e reja të punësimit dhe se si ato mund të ndihmojnë në adresimin e rekrutimit dhe mbajtjes, duke mbrojtur të drejtat e punonjësve dhe përfshirjen sociale.
- + **Krijimi** i 'udhërrëfyes' praktik për punëdhënësit, punonjësit dhe të vetëpunësuarit në mënyrë që ata të kuptojnë më mirë format e reja të punësimit dhe t'i përdorin ato për të mirën e të gjithëve.
- + **Krijimi** i një paketë metodike dixhitale në internet që mund të udhëzojë organizatat dhe individët përmes adoptimit të formave të reja të punësimit, të mbështetura nga studimet dhe rastet e praktikave më të mira.
- + **Hartimi** dhe testimi i një kursi online për ngritjen e kapaciteteve për stafin që dëshiron të bëhet ekspert në format e reja të punësimit.
- + **Organizimi** i Konferencës së parë Evropiane mbi Format e Reja të Punësimit në Sport, e cila synon palët e interesuara me ndikim në sektorin e sportit për të rishikuar rezultatet e projektit dhe për të dhënë rekomandime për qëndrueshmëri.

# PËRFITIMET E PRITSHME

**INFORMS**  
Innovative Forms of Employment in Sport

IN-FORMS parashikon të ketë ndikimet e mëposhtme:

+ **Të përmirësojë** të kuptuarit të sektorit për format e reja të punësimit dhe potencialin e tyre për të adresuar sfidat e fuqisë punëtore të punëdhënësve dhe për të ofruar mundësi më të dobishme dhe afatgjata karriere për punonjësit dhe të vetëpunësuarit.

+ **Të ndihmojë** politikëbërësit dhe vendimmarrësit në nivelet e BE-së, kombëtare, rajonale dhe lokale për të vlerësuar përfitimet dhe rreziqet e mundshme të formave të reja të punësimit, përshtatjen e politikave të tyre në përputhje me rrethanat dhe, nëse është e nevojshme, adresojnë pengesat ligjore dhe rregullatore.

+ **Të ndihmojë** punëdhënësit, punonjësit dhe të vetëpunësuarit që të angazhohen me forma të reja punësimi në mënyrë efektive, të drejte dhe etike, nëpërmjet ofrimit të burimeve praktike, të drejtë dhe etike duke ofruar burime praktike, lehtësisht të disponueshme dhe me mbështetje eksperte.

+ **Të stimulojë** zhvillimin e një force punëtore në sport më të qëndrueshme, të sigurt, të punësuar ligjërisht dhe profesionale, e cila mund t'i përgjigjet në mënyrë fleksibile nevojave të sektorit që evoluojnë me shpejtësi.

## PARTNERITETI

Koordinuar nga Observatori Evropian i Sportit dhe Punësimit (EOSE), IN-FORMS mbledh së bashku 12 palë të interesuara nga organizatat e punëdhënësve, federatat, një ministri, institut kërkimor dhe universitetet në 10 vende për t'i bërë realitet qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e planifikuara të projektit, e gjithashtu duke promovuar rrjetet e detikuara në inovacion në të gjitha nivelet.



European Observatoire of Sport and Employment (EOSE)  
France, Europe - Coordinator



Fédération Nationale Profession Sport et Loisirs (FNPSL)  
France



Sportwerk Vlaanderen  
Belgium



LUNEX  
Luxembourg



Werkgevers in de Sport  
Netherlands



Polytechnic Institute of Santarém / Sport Sciences School of Rio Maior (ESDRM) - Portugal



HELLENIC REPUBLIC  
Ministry of Education, Religious Affairs and Sports  
General Secretariat of Sports

General Secretariat of Sports, Ministry of Education, Religious Affairs and Sports - Greece



Arbetsgivaralliansen  
Sweden



Sport Institute-National Research Institute - Poland



Portuguese Swimming Federation  
Portugal



Romanian Football Federation  
Romania



Institute of Sports Research / Sports University of Tirana - Albania

IN-FORMS është bashkëfinancuar në kuadër të programit Erasmus+ Sport dhe zgjat nga Janari 2024 deri në Dhjetor 2026. **Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni: [eosesec@eose.org](mailto:eosesec@eose.org)**



VIZITO FAQEN E IN-FORMAVE

[www.informs-sport.eu](http://www.informs-sport.eu)



Co-funded by  
the European Union

Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose EACEA. As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti dhënies nuk mund të mbahen përgjegjës për to.